



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Pridata Received/Delivery	09-10-2023	3	viti god. year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTOK	6474/2023		1/7



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1118/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1118/2023 të datës 25.08.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokati me adresë:

kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 09.10.2023 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1118/2023 e datës 25.08.2023 e parashtruar nga ankuesi**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër reference Nr. ref.282/023 i datës 18.08.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.**

**A r s y e t i m**

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr. 132/2022 të datës 07.07.2022 në pozitën e punës "Drejtor i Departamentit për Amerikë" në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Zëvendësuesi i Sekretarit i Përgjithshëm në cilësinë e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë më datë 28.03.2023 ka parashtruar kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor me arsyetimin se: "Ekziston dyshimi i bazuar se ankuesi në cilësinë e Drejtorit të Departamentit për Amerikë në periudhën kohore nga data 07.07.2022 e deri më tani, ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë gjatë ushtrimit të funksionit të tij si Drejtor i këtij Departamenti".

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 29.03.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. Ref: 99/2023 përmes të cilit ka bërë pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës pas zhvillimit të procedurës disiplinore më datë 26.04.2023 ka nxjerr Vendim me numër të referencës Nr.ref.157/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore sipas 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3,3.6, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*", duke shtuar se masa disiplinore bazohet në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi kundër Vendimit me numër reference Nr.ref. 157/2023 të datës 26.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 25.05.2023 përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit \_\_\_\_\_ ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4418/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor se Vendimi me numër reference Nr.ref 157/2023 i datës 26.04.2023 përmban shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 24.07.2023 ka marrë Vendim me numër A.nr.779/2023, me të cilin e ka obliguar Komisionin Disiplinor në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që në brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor të bëj **Rishqyrtimin** e lëndës për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit

Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në zbatim të Vendimit me numër A.nr.779/2023, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka rishqyrtuar rastin e ankuesit, ndërsa më datën 18.08.2023 ka nxjerr Vendim me numër të referencës Nr.ref.282/2023 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „*Largim nga Shërbimi Civil*” për shkak se: *Në kundërshtim me detyrimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 26 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku gjatë komunikimit zyrtar më datë 07.07.2022 ka deklaruar se nuk e njeh autoritetin e Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë; në kundërshtim me detyrimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 26 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ka refuzuar pjesëmarrjen në takimet me Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD, përkatësisht Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë të caktuara më datat 01.12.2022, 09.09.2022, 05.08.2022 dhe 21.03.2023; në kundërshtim me detyrimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 26 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ndërmjet datës 13-17 Mars 2023, pa miratim paraprak dhe jashtë nivelit ka caktuar dhe mbajtur takim me Sekretarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës; në kundërshtim me nenit 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik pa asnjë provë dhe argument denoncon Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm për ndërhyrje në e-mailin e tij.*

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër reference Nr.ref.282/2023 të datës 18.08.2023, më datë 25.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5816/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.09.2023 Këshilli ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa

Këshilli më datë 25.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa me numër protokoll 5816/2023 e datës 25.08.2023 e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit Av. në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 23.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 25.09.2023; Vendim me numër reference nr.ref.282/2023 i datës 18.08.2023; Ankesa me numër protokoll 4418/2023 e datës 25.05.2023 e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit Av. në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër reference Nr.ref.157/2023 i datës 26.04.2023 i Komisionit Disiplinor në MPJD; Vërejtje me numër reference Nr.ref.287/2022 e datës 02.09.2022; Vërejtje me numër reference Nr.ref. 311/2022 e datës 16.09.2022; Vërejtje me numër reference Nr.ref.24/2023 e datës 01.02.2023; Vendim me numër A.nr.417/2023 i datës 24.03.2023 i KPMSHCK; Vendim me numër A.nr.216/2022 i datës 14.04.2022 i KPMSHCK; Plani individual i punës për vitin 2023 i datës 30.01.2023; Vërejtje me numër reference Nr.ref.13/2023 e datës 23.01.2023; Vendim me numër A.nr.445/2023 i datës 14.04.2023 i KPMSHCK; E-mail i datës 15.11.2022; E-mail i datës 08.09.2022; E-mail i datës 16.08.2022; Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore e datës 28.03.2023; Vendim për pezullimin e marrëdhënies së punës me numër reference Nr.ref.99/2023 i datës 29.03.2023; E-mail i datës 11.05.2022; Vendim me numër A.nr.461/2022 i datës 01.07.2022 i KPMSHCK; E-mail i datës 10.05.2023; E-mail i datës 18.08.2023; E-mail i datës 09.08.2023; E-mail i datës 05.08.2022; E-mail i datës 10.08.2022; E-mail i datës 25.07.2022; E-mail i datës 21.07.2022; E-mail i datës 08.09.2022; Procesverbal i takimit në mes Departamentit për Amerika (DA) dhe diplomatëve të SHBA-ve në Kosovë i datës 07.09.2022; E-mail i datës 20.01.2023; E-mail i datës 11.10.2022; Miratim Paraprak për Projekt-rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 24.12.2021; Kërkesë nga MPJD për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të Projekt Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e datës 05.01.2022; Vendim me numër 214/2022 i datës 01.02.2022; Vendim me numër A.nr.413/2020 i datës 04.02.2023 i KPMSHCK; Raport Javor i datës 10.03.2023; Raport Javor i datës 17.03.2023; Autorizim i datës 04.05.2023; E-mail i datës 21.03.2023; E-mail i datës 17.08.2022; E-mail i datës 28.03.2023; E-mail i datës 02.09.2022; E-mail i datës 19.09.2022; E-mail i datës 16.09.2022; E-mail i datës 29.03.2023; E-mail i datës 31.01.2023; Listë e datës 01.12.2022; Listë e takimit javor me drejtorët politikë të MPJD e datës 31.08.2022; Listë e takimit javor me drejtorët politikë të MPJD 05.08.2022; Listë e takimit javor me drejtorët politikë të MPJD e datës 16.09.2022; Listë e takimit javor me drejtorët politikë të MPJD e datës 09.09.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë 13.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 16.06.2023; Fletkthesë; E-mail i datës 12.04.2023; Procesverbal i mbledhjes së komisionit disiplinor i datës 18.04.2023; Procesverbal i mbledhjes së komisionit disiplinor i datës 29.03.2023; Procesverbal i mbledhjes së komisionit disiplinor i datës 18.04.2023; Procesverbal i mbledhjes së komisionit disiplinor i datës 26.04.2023; E-mail i datës 26.04.2023; Vendimin me numër 08/2022 të datës 10.01.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Vendim me numër VK/2023 i datës 06.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar, se ankesa e ankuesit, është e papabazuar, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër të referencës Nr.ref.282/2023 të datës 18.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shqiptimin e masës disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", pretendon se vendimi i atakuar karakterizohet me shkelje dhe mangësi të mëdha materiale si dhe vërtetim të pasaktë të gjendjes faktike gjegjësisht pretendon se inicimi i procedurës disiplinore është bërë nga personi jo kompetent respektivisht nga personi i paautorizuar ngase Sekretari i Përgjithshëm ka disa muaj që ka tejkuluar çdo afat kohor të përcaktuar me ligj për të mbajtur pozitën e Zëvendësuesit dhe nuk posedon fuqinë e autoritetit më të lartë administrativ gjegjësisht nuk është Udhëheqësi i tij i Drejtpërdrejtë; Për sa i përket udhëzimeve për ambasadat e gjeografisë i njëjti pretendon se ka mbulueshmëri përmes komunikimeve elektronike drejtuar zyrtarëve kompetent e gjithashtu edhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë; Ndërsa lidhur me kontestimin e akteve nënligjore të lëshuara nga institucionet shtetërore konkretisht Vendimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve si dhe Vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil të Kosovës, ankuesi pretendon se është e drejtë Kushtetuese dhe ligjore që secili person që mendon se me një Vendim apo akt juridik i është cenuar ndonjë e drejtë si palë në procedurë mund të përdorë mjetet juridike në këtë rast mjetin e rregullt juridik ankesën nëse interesat e tij preken thelbësisht.

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, rrjedhimisht i njëjti sipas Akt-it të Emërimit AE.Nr.132/2022 të datës 07.07.2022 ushtron pozitën e punës „Drejtor i Departamentit për Amerikë”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se inicimi i procedurës disiplinore është bërë nga personi jo kompetent respektivisht nga personi i paautorizuar konstaton se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse ankuesi sipas Akt Emërimit AE.Nr.132/2022 të datës 07.07.2022 mban pozitën „Drejtor i Departamentit për Amerikë”, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, andaj Kolegji i'u referua nenit 11 paragrafi 3 të Rregullores (ZKM) Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me të cilin është përcaktuar se: **3. Drejtori i Departamentit për Amerikë raporton te Sekretari i Përgjithshëm....**” po ashtu duke i'u referuar këtij përcaktimi ligjor e në mbështetje të dispozitave të nenit 19 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi në cilësi të Drejtorit të Departamenti për Amerika, lidhur me punët dhe veprimtarinë e Departamentit i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të departamentit përfshirë edhe objektivat e divizioneve përbërëse, monitorimin e veprimtarisë së tyre dhe për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre. Kolegji i Këshillit po ashtu i'u referua edhe dispozitave të nenit 18 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, të cilat shprehimisht parashohin se: *Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror. 2. Sekretari i Përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e ministrit. 3. Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore: 3.1. mbështet ministrin në punën e tij; 3.2. siguron koordinimin e hartimit të politikave në ministrinë përkatëse; 3.3. siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislationit, të politikave dhe të vendimeve të ministrit; 3.4.*

siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror; 3.5. siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura; 3.6. vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi; 3.7. çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga ministri, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se Sekretari i Përgjithshëm në këtë rast i MPJD-së është autoriteti më i lartë ekzekutiv/administrativ i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale, kështu që i njëjti sipas dispozitave të lartcekura ka të drejtën e inicimit të procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor në pajtim me nenin 48 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku është përcaktuar se: "4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit; 4.3. me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore", andaj mbi këtë bazë si dhe bazuar edhe në Vendimin me numër 08/2022 të datës 10.01.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me caktimin e Zëvendësues i Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kolegji i Këshillit, konstaton se iniciimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është në pajtim me dispozitat e lartcekura, kështu që ky pretendim ankimor i ankuesit si i tillë është i pabazuar. Po ashtu Kolegji me rastin e konstatimit sa i përket këtij pretendimi mori për bazë edhe Vendimin e Këshillit me numër A.nr.417/2023 të datës 24.03.2023 përmes se cilit i është refuzuar ankesa e ankuesit lidhur me shqiptimin e masës disiplinore „Vërejtje” si dhe është konfirmuar se për nga hierarkia mbikëqyrës i drejtpërdrejtë në kohën kur ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore i cili ka qenë në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Amerikë është Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji i Këshillit po ashtu pasi ka analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi në mënyrë të vazhdueshme ka refuzuar të njohë autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm/Zyrtarit Kryesor Administrativ të MPJD-së, në atë mënyrë që i njëjti në komunikimet e tij zyrtare me Sekretarin e Përgjithshëm ka përdorur shënimin "N/A (nuk është e aplikueshme)", siç është rasti me përgatitjen e Planit Individual të Punës për Departamentin për Amerika ku ankuesi të rubrika e mbikëqyrësit nuk kishte vendosur emrin dhe mbiemrin e Sekretarit të Përgjithshëm si mbikëqyrës i tij por i njëjti vendos shkrimin "N/A (nuk është e aplikueshme)", si dhe në mënyrë të vazhdueshme ankuesi ka refuzuar pjesëmarrjen në takimet zyrtare të thirrura nga Sekretari i Përgjithshëm, ku si pasojë e këtyre veprimeve ankuesit i janë shqiptuar edhe masa tjera disiplinore paraprake dhe atë sipas shkresës më numër Ref: 287/2022 të datës 02.09.2022 dhe shkresës Nr.Ref: 311/2022 të datës 16.09.2022 të shqiptuara nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, mirëpo që i njëjti edhe pas vërejtjeve të shqiptuara ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023 të mos marrë pjesë në takimet e ftuara nga Sekretari i Përgjithshëm siç është rasti me ftesën e datës 21.03.2023, kështu që mbi bazën e këtyre rrethanave Kolegji vlerëson se veprimet e ankuesit bien ndesh më nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: "Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit.

Lidhur me komunikimet të cilat ankuesi i ka dërguar dhe ka dhënë udhëzime për ambasadat e gjeografisë pa qenë në dijeni dhe pa pëlqim të mbikëqyrësit të tij të drejtpërdrejtë/Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar Rregulloren (ZKM) me numër Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe

Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përkatësisht nën 11 paragrafin 1 dhe 2 si dhe nën paragrafin 2.6, 2.8 dhe 2.11 ku përcaktohet qartë se: *"1. Departamenti për Amerikë ka për mision fuqizimin e subjektivitetit shtetëror ndërkombëtar të Republikës së Kosovës përmes vendosjes dhe përfundimit të marrëdhënieve diplomatike dhe bashkëpunimit bilateral me shtetet e kontinenteve të Amerikës Veriore dhe asaj Jugore. Departamenti, gjithashtu, ka për qëllim të ofrojë informata për formësimin e qëndrimit të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me këto shtete duke bërë analiza të rregullta dhe raporte të veçanta"*, ndërsa në paragrafin 2 ku përfshihen detyrat dhe përgjegjësit e këtij departamenti përkatësisht nën paragrafin 2.6, 2.8 dhe 2.11 përcaktohet se: 2.6. *"Mban kontakte me misionet diplomatike të akredituara në Republikën e Kosovës"* 2.8. *"Krijon një arkiv të komunikimit zyrtar në kuadër të ministrisë lidhur me marrëdhëniet bilaterale me shtetet e gjeografive që mbulon"* 2.11. *"Në baza ditore mbikëqyr punën e misioneve diplomatike dhe të përfaqësive të Republikës së Kosovës në zonat gjeografike, të theksuara më lartë"*, po ashtu ka analizuar edhe komunikimet elektronike të datës 21.07.2022, 09.08.2022, 08.09.2022, 17.10.2022 si dhe 17.03.2023 ku ankuesi ka raportuar për punën e tij dhe ka konstatuar se i njëjti në asnjë komunikim nuk e ka përfshirë dhe nuk e ka njoftuar Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, edhe përkundër faktit se ankuesi ashtu siç është sqaruar edhe me lartë raporton drejtpërdrejtë te Sekretari i Përgjithshëm, andaj mbi këtë bazë sipas Kolegjit të Këshillit, rezulton fakti se ankuesi me këto veprime ka shmangur detyrimet ligjore të përcaktuara me menin 25 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përfundimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike"*, nën 26 paragrafi 1 dhe nën 28 të këtij ligji, kështu që pretendimi i ankuesi sa i përket kësaj çështje është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se prononcimet në media i ka bërë me autorizimin e kryesisë së Shoqatës Sindikale të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ngase i njëjti është anëtarë i kësaj Shoqate Sindikale, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të masës disiplinore dhe fakteve të prezantuara nga palët në procedurë, vlerëson se këto pretendime nuk kanë ndërlidhmëni me përkrahimin e detyrave të punës të ankuesit. Rrjedhimisht Kolegji konstaton se çështja e regjistrimit të sindikatës nuk është në domenin e fushëveprimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ashtu siç pretendon organi i punësimit, mirëpo meqenëse ankuesi pretendon se ka pasur autorizim nga kryesia e sindikatës për prononcim në media Kolegji nga administrimi i shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se ankuesi me asaj provë nuk ka arritur të dëshmojë ndonjë autorizim apo pëlqim me shkrim të kryesisë së sindikatës dhe as të menaxherit drejtues të organit punëdhënës për prononcim në media, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit edhe ky pretendim ankimor për arsyet si më lartë është i pabazuar.

Andaj bazuar për sa më sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, ka vepruar në pajtim me nën 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, ndërsa Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e nxjerrjes

së Vendimit me numër reference Nr.ref.282/2023 të datës 18.08.2023 në mënyrë të drejtë ka konstatuar se veprimet e përsëritura te ankuesit përbejnë shkelje disiplinore duke vepruar kështu në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase janë konstatuar në mënyrë të saktë elementet e përgjegjësive disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit*, po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, nenin 12, nenin 13 paragrafi 3 dhe paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, dhe se në këtë rast Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përveç kësaj Vendimin e ka nxjerr duke u bazuar në provat vendimtare që kanë të bëjnë me rastin konkret, dhe të njëjtin e ka arsyetuar në përputhje të plotë me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit ndaj këtij vendimi janë pretendime të pabazuara dhe të pa argumentuara me prova konkrete.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave duke marr parasysh të gjitha provat e bashkëngjitura të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1118/2023

**Avdyl BEKETSHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.